




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-01/2039/22
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-05-2022
Nr. lfaq. 02	Data 06-05-2022
Broj stranica	02
Nr. pages	02



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2591/21, për zyrtarin e lartë z. Besian Mustafa, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë, në rast se paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Pas identifikimit të rastit lidhur me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), ka hapur rastin me numër protokollit AKK-DPKI-06-2591/21, për zyrtarin e lartë z. Besian Mustafa, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia ka filluar trajtimin e rastit në fjalë, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse, prej nga rezultoi se z. Besian Mustafa, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, mban njëkohësisht edhe funksionin e Drejtorit dhe Përfaqësuesit të Autorizuar në Biznesin “Gainsight Services” SH.P.K.



Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/1853/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë i cili e ka njoftuar palën lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë Drejtor dhe/ose Përfaqësues i Autorizuar në biznes, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

*1. "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Besian Mustafa është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar njëherit se biznesi në fjalë është pasiv dhe se nuk zhvillon ndonjë aktivitet, por gjithsesi do të ndërmarra veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-01/1853-1/22), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Besian Mustafa ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë Drejtor e as Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat "Gainsight Services" SH.P.K.


Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë, nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

  
Yll Buleshkaj  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit